



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 679 Prot.

Tiranë, më datë 17.04 2023

VENDIM
Nr. 257, datë 27.04.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 27.04.2023:

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin “Restaurim i objekteve 1 dhe 2 kate, bar Flo”, brenda kufirit Qendër Historike Shkodër, me Nr. Pasurie 4/782, Zona Kadastrale 8593, Bashkia Shkodër, me aplikues Agron Islami dhe zhvillues **Indrit Bushati** dhe plotësimin e aplikimit me pikat e mëposhtme:
 - Të plotësohet projekti me dokumentin e pronësisë për objektin 2 katësh, si dhe të sillet dokumenti i pronësisë për objektin 1 katësh i rifreskuar;
 - Të pasqyrohen grafikisht në projekt ndërhyrjet e parashikuara në preventiv;
 - Të ruhet lartësia e çatisë ekzistuese për objektin 1 katësh;
 - Të ruhet volumi i objektit ekzistues;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
3. Ndaj vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

